

Ceresit

FUGIM MË I SHPEJTË, MË I PASTËR DHE MË EFIKAS!

CE 60 FUGË MASË - GATI PËR PËRDORIM



Henkel

Fugë masë inovative e gjeneratës së re!

E disponueshme në **14** nuanca moderne dhe bashkëkohore

White	01
Pergamon	39
Silver	04
Manhattan	10
Gray	07
Cementgray	12
Antracite	13
Graphite	16
Coal	18
Jasmine	40
Bahama	43
Caramel	46
Toffi	44
Chocolate	58

CE 60 fugë masë inovative e gatshme për përdorim, bazohet në një kombinim unik të dispersioneve polimerike dhe vendos një standard të ri për fugimin. Produkti është menjëherë i gatshëm për përdorim, duke mundësuar fillim të shpejtë të punës. Me CE 60 gjithmonë do të arrini rezultate afatgjata dhe të nivelit superior. Harroni ngjyrat jo uniforme të fugave dhe njollat në hapësirat ndërmjet pllakave. Ceresit CE 60 është zgjedhja ideale për të gjitha punimet e brendshme, e përshtatshme për të gjitha llojet e pllakave qeramike dhe gurit natyral.



Cilësi pa kompromis!

Përzjerje e thjeshtë, pa pluhur, pa pritje me orë të tëra dhe pa mbeturina? Tingëllon e pamundur? Binduni vetë dhe shiheni krahasimin ndërmjet fugë masë Ceresit CE 60 dhe fugë masë të çimentos.

	Fugë masë çimentoje	CE 60 fugë masë - gati për përdorim
Lidhësi	kombinim i lidhësve mineralë	një kombinim unik i dispersioneve polimerike.
Nevojitet ujë për përzjerje	po	jo
Metoda e përzjerjes	me trapano ose me dorë, shumë pluhur manualisht	manualisht, pastër dhe pa pluhur
Koha e përzjerjes	rreth 5 minuta (2 përzjerje me kohë pritjeje ndërmjet tyre)	më pak se 30 sekonda
Koha e pastrimit	5-45 minuta, në varësi të llojit të pllakave	pa pritje, pastrim brenda 10 minutave nga aplikimi
Numri i cikleve të pastrimit	2 deri në 3, +1 ditën e ardhshme	1 deri 2
Ecshmëria	rreth 8-12 orë	rreth 24 orë
Kapaciteti mbajtës i ngarkesës	7 ditë	7 ditë
Koha e përpunimit (koha e pjekjes)	20-90 minuta	e pakufizuar (pa kohë përpunimi)
Ripërdorimi i produktit	jo	po
Konsumi	0.5 kg/m ²	0.35 kg/m ²
Riparimi i gabimeve në fugim	po, por me një rrezik të lartë të ngjyrës së pabarabartë	po, me një ngjyrë plotësisht uniforme edhe pas shumë vitesh
Homogjeniteti i sipërfaqes	parregullsi të vogla	shumë homogjene
Uniformiteti i ngjyrës	varet nga seria e prodhimit dhe aftësia e kontraktorit	100% ngjyrë homogjene dhe e qëndrueshme
Rreziku i hijezimit	i lartë	pa hijezim
Rreziku i çngjyrosjes	i lartë	nuk ka njollasje
Rreziku i njollave	i lartë	shumë i ulët
Rezistencë ndaj UV-së	jo	po*
Humbje	i lartë	i ulët




Shihni më shumë përfitime!

Nëse dëshironi të shihni se si funksionon CE 60 në krahasim me fugë masë çimentoje, skanoni QR kodin dhe shikoni një video të shkurtër.


*testuar sipas standardit ISO 16474-3




SI PËRDORET



Hap kovën.




Përzieni shkurt përmbajtjen me një mikser ose shpatull derisa të formohet një konsistencë homogjene, jo më shumë se 30 sekonda.




Bëjeni fugimin në një sipërfaqe maksimale prej 2 m² në të njëjtën kohë. Aplikoni masën me një mistri gome dhe hiqni menjëherë materialin e tepërt.



Pastroni sipërfaqen me ujë të ngrohtë brenda 10 minutave nga aplikimi. Së pari, lani me kujdes të gjithë sipërfaqen me një sfungjer të lagur, dhe më pas hiqni mbetjet e fugë masës nga sipërfaqja e pllakave. Përdorni sa më pak ujë të jetë e mundur për të shmangur dëmtimin e sipërfaqes. Mos shtypni shumë fort në nyje. Punoni në sipërfaqe më të vogla (maks. 2 m²): aplikoni masën, jepni formë fugës, pastroni dhe vazhdoni me zonën tjetër, duke përsëritur të njëjtin proces.



Filloni pastrimin MENJËHERË, më së voni brenda 10 minutave. Në rast të formimit të një filmi, një agjent pastrimi i posaçëm mund të përdoret pas të paktën 24 orësh.



Mbylleni kovën, masa e mbetur për fugim mund të përdoret përsëri.



SHËNIM! Rekomandohet të punohet në shirita vertikale për të shmangur depërtimin e ujit në fugat e pambushura gjatë procesit të larjes.

KËSHILLA TË ARTA



1. MËNYRA E APLIKIMIT NDRYSHON NGA PROCEDURA E PËRDORIMIT TË FUGË MASËS ME BAZË ÇIMENTOJE.

CE 60 nuk është vetëm një produkt i ri, por një teknologji krejtësisht e re. Aplikojeni atë me një mistri gome me lëvizje të shkurtra, duke lënë një sasi minimale mase mbi pllaka.



2. PËRDORNI SASI TË VOGLA TË PRODUKTIT GJATË APLIKIMIT

Aplikoni një sasi të vogël të përbërjes në mistri dhe gjatë punës përqendrohuni vetëm në mbushjen e fugave, me sa më pak aplikim të jetë e mundur në sipërfaqen e pllakave.



3. PASTRONI MENJËHERË FUGË MASËN E APLIKUAR, MË SË VONI 10 MINUTA PAS APLIKIMIT

Filloni pastrimin e pllakave MENJËHERË, d.m.th. jo më vonë se 10 minuta pas aplikimit, në mënyrë që të shmangni mbetjet masive të mbetura në sipërfaqe.



4. MOS SHTONI UJË

Mos shtoni kurrë ujë në fugë masën CE 60. Përzieni mirë produktin derisa të bëhet homogjen, manualisht, me spatulë ose me mistri.



5. APLIKONI HAP PAS HAPI DHE NË SIPËRFAQE TË VOGLA - APLIKO, FORMËSO, PASTRO

Aplikoni fugë masën në një sipërfaqe më të vogël (maks. 2 m²), jepni formë fugave, pastroni (më së voni në afat prej 10 minutave) dhe vazhdoni me sipërfaqen tjetër, duke përsëritur të njëjtin proces.



6. PASTRONI ME SFUNGJER TË LAGËSHT, JO TË LAGUR SHUMË (TË NJOMË)

Mos e lagni shumë sfungjerin, pasi që shumë ujë mund ta dëmtojë produktin.



7. PËRDORNI UJË TË NGROHTË GJATË FORMËSIMIT - E BËN PUNËN MË TË LEHTË

Formësimi është më i lehtë me ujë të ngrohtë. Uji i ftohtë zgjat procesin e lidhjes.



8. PËR PASTRIMIN E DYTË, PËRDORNI UJË TË PASTËR

Për të arritur një sipërfaqe të pastër pa mbetje, ndërroni ujin për pastrimin e dytë.



9. HIQNI MBETJET ME UJË TË NGROHTË

Nëse në pllaka shfaqen mbetje 1 orë pas pastrimit, lagini ato me ujë të ngrohtë (jo të valuar), lëri për disa minuta dhe pastrojeni përsëri.



10. SKANO QR KODIN PËR VIDEO "SI TË PËRDORET"

Shikoni videon që tregon në detaje të gjitha aspektet e punës me fugë masën Ceresit CE 60. Sa më të informuar të jeni, do të arrini rezultate më të mira.

ceresit.al

[Ceresit](https://www.facebook.com/Ceresit)

[ceresitkosova](https://www.instagram.com/ceresitkosova)

[ceresit Kosova](https://www.youtube.com/channel/UC...)

#NDËRTOJ MËSËBASHKU



Deri 3 herë fugim më i shpejtë

Punimet përfundojnë më shpejt falë fugë masës CE 60. Përzierje dhe pastrim më i shpejtë, koha më e shkurtër e pritjes dhe formësimi më i lehtë lejojnë fugimin deri në 3 herë më të shpejtë krahasuar me fugë masën e çimentos.



Gati për përdorim dhe ripërdorim

Gjithmonë gati për përdorim dhe mund të përdoret përsëri. Pas fugimit, mbylleni kovën dhe përdoreni masën e mbetur më vonë.



Rezistencë e jashtëzakonshme ndaj njollave

CE 60 ka veti hidrofobike dhe një strukturë të dendur që parandalon depërtimin e papastërtive në fugë.



Nuk ka nevojë për ujë për përzierje.

CE 60 është një masë e gatshme për fugim – pa pluhur dhe pa humbje të kohës.



100% stabilitet ngjyrash i garantuar

Falë formulës inovative që nuk kërkon përzierje me ujë, mund të jeni të sigurt se ngjyra e fugës do të përmbushë pritjet tuaja. Harrojeni pabarazinë dhe ndryshimin e ngjyrës. **Ceresit CE 60 ofron ngjyrë 100% homogjene dhe të qëndrueshme me kalimin e viteve.**



Korrigjimi i gabimeve në fugim

Është e mundur që gabimet të korrigjohen më pas me CE 60. Korrigjimet nuk do të jenë të dukshme sepse CE 60 është gjithmonë me të njëjtën ngjyrë, kështu që mund të arrihen korrigjime krejtësisht të padukshme.



Rezistencë e lartë ndaj gërryerjes

Qëndrueshmëria e përmirësuar e polimerit të poliuretanit e kombinuar me strukturën e fortë të rrës së kuarcit i siguron CE 60 rezistencë të jashtëzakonshme ndaj konsumimit dhe gërvishjeve. **Mbrojtja e shkëlqyer kundër ngarkesave mekanike** garanton jetëgjatësinë e produktit.



Qëndrueshmëri

Si një masë e gatshme për fugim, CE 60 ul ndjeshëm konsumin e ujit. Paketimi është bërë nga 55% materiale të ricikluara.